



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1099/prot  
/4

Tiranë më 28.9.2022

VENDIM

Nr. 48 datë 23.09.2022

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT  
REALIZUAR PRANË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA TË  
UNIVERSITETIT TË TIRANËS “**

Në mbështetje të neneve 3 pika 3/c, 47, 49 e në vijim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 14, e në vijim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 12 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, bazuar në planin vjetor 2022, për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të UT, miratuar me shkresën nr. 41 datë 25.10.2021, Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit me objekt “*Auditim i përputhshmërisë dhe financiar*” së aktivitetit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, për periudhën 01.10.2019 deri më 31.12.2020, realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.prot. 1099/1, datë 13.04.2022 “Për angazhimin e auditimit për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës”,
2. Ky Raport Përfundimtar i përcillet zyrtarisht Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, së bashku me plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

